



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA  
KOSOVA CUMHURIYETI  
Komuna e Prizrenit • Opština Prizren  
Prizren Beledijesi  
Kryetari i Komunës • Predsednik Opštine  
Belediye Başkanı

01 Nr. 217/26 Dt. 12.05.2026



Republika e Kosovës  
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit  
Opština Prizren – Prizren Beledijesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008), nenit 1 paragrafi 2, nenit 3 paragrafi 2 dhe nenit 14 paragrafi 1 Rregullores Komunale nr. 001-011-201, datë 03.01.2024, për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve, Transfereve dhe Grantëve, si dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643, të datës 15.10.2008, pas kërkesës 01-400 nr. 52631, datë 04.05.2026, të Nergjivan Mustafa Xhabalit, kryetari i Komunës, merr këtë:

### V E N D I M

#### Për lejimin e mjeteve financiare

1. Miratohet kërkesa 01-400 nr. 52631, datë 04.05.2026, e Nergjivan Mustafa Xhabalit, për lejimin e mjeteve financiare për mbulimin e shpenzimeve lidhur me pjesëmarrjen e nxënësit Orikum Xhabalit, në Finalen Ndërkombëtare të Gjuhës Angleze, e cila mbahet në Itali, kështu që, për këtë qëllim dhe në emër të mbulimit të shpenzimeve që lidhen me udhëtimin, akomodimin, etj., lejohen mjetet financiare në shumën prej 500.00 € (pesëqind euro).
2. Shuma e lejuar, e përshkruar si në pikën 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës—pozicioni i subvencioneve dhe transfereve i Zyrës së Kryetarit të Komunës.
3. Obligohet Drejtoria për Ekonomi dhe Financa për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës  
Shaqir Totaj



- Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
  - Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës,
  - Të lartcekurit,
  - Arkivës së Kryetarit.